



DEMAND FOR JUSTICE
KËRKO DREJTËSI
TRAŽI PRAVDU



**NDIHMA JURIDIKE FALAS NË ÇËSHTJET PENALE
DHE ZBATIMI I STANDARDEVE TË GJYKATËS
EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT
NGA GJYKATAT E KOSOVËS**



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Institut Prave Kosova
Kosovo Law Institute

Shtator 2017

Programi Kërko Drejtësi është i financuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës/INL dhe e implementuar nga National Center for State Courts për të mbështetur një zhvillim të fuqishëm të kërkesës për drejtësi në Kosovë të bazuar në dëshmi. Nëpërmjet programit Kërko Drejtësi, NCSC është duke mobilizuar partnerët e Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) për të vepruar si agjentë të ndryshimit duke nxitur llogaridhënien, transparencën dhe integritetin në sektorin e drejtësisë.

Ky raport është bërë i mundur me mbështetje nga Departamenti Amerikan i Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës/INL përmes programit Kërko Drejtësi. Mendimet, të gjeturat, dhe konkludimet apo rekomandimet në këtë raport i përkasin autorit dhe nuk paraqesin mendimet e Departamentit Amerikan të Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës/INL ose të National Center for State Courts.

AUTORË:

Ehat Miftaraj dhe Betim Musliu

Hulumtimi është mbështetur nga Fjorda Vllasolli dhe ekipi i hulumtuesve të terrenit: Kaltrina Ajvazi, Sabina Pergega, Suzana Manaj, Leotrim Bytyçi, Martin Komani, Albulena Mujaj Bajraktari, Rita Gacaferi dhe Erestina Buja.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

KONTAKTI

IKD

Rr. Rustem Statovci, Hyrja 1, Nr.1

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

© Të gjitha të drejtat e këtij botimi janë të rezervuara nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD). Të drejtat dhe prona intelektuale mbrohen me Ligjin për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE	4
1. HYRJE.....	5
2. METODOLOGJIA.....	7
2.1. HULUMTIMI PARAPRAK:.....	7
2.2. MONITORIMI	7
2.3. INTERVISTAT	7
2.4. ANALIZA E VENDIMEVE GJYQËSORE TË FORMËS SË PRERË.....	8
2.5 FOKUS GRUPI I PALËVE TË INTERESIT TË SISTEMIT TË DREJTËSISË.....	8
3. OFRIMI I NDIHMËS JURIDIKE NË KOSOVË: NJË KORNIZË LIGJORE E NDIKUAR NGA KEDNJ.....	9
3.1 KEDNJ DHE KUSHTETUTA E KOSOVËS.....	9
3.2 KODI I PROCEDURËS PENALE DHE E DREJTA PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS..	10
3.3 LIGJI PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS.....	11
3.4 PRAKTIKA GJYQËSORE E GJEDNJ-SË: KRITERI “FINANCIAR” DHE “INTERESI I DREJTËSISË”	12
4. MEKANIZMAT PËR OFRIMIN E NDIHMËS JURIDIKE FALAS.....	14
5. PRAKTIKA AKTUALE E KOSOVËS E NDIHMËS JURIDIKE FALAS NË PROCEDURA PENALE.....	15
5.1 GJETJET E MONITORIMIT DHE SITUATA NË PRAKTIKË	16
5.2 TË DHËNAT E MBLEDHURA NGA INTERVISTAT E TË PANDEHURVE.....	18
5.3 INTERVISTAT ME GJYQTARËT	19
5.4 ANALIZA E VENDIMEVE GJYQËSORE TË FORMËS SË PRERË.....	22
6. PËRFUNDIME	24
7. REKOMANDIME.....	25

LISTA E SHKURTESAVE

1. **GjTh** - Gjykatat Themelore
2. **GJEDNJ** - Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
3. **IKD** - Instituti i Kosovës për Drejtësi
4. **KGJK** - Këshilli Gjyqësor i Kosovës
5. **KPPRK** - Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës
6. **KEDNJ** - Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
7. **NJF** - Ndihma Juridike Falas
8. **OAK** - Oda e Avokatëve të Kosovës
9. **OSBE** - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

1. HYRJE

Komuniteti Evropian njih 'Ndihmën Juridike' në çështjet penale, civile dhe administrative si të drejtë të njeriut. Përderisa shumë qytetarë evropianë kanë mjete për të përballuar financiarisht përfaqësuesin e tyre ligjor, qeveritë, gjyqësorët dhe komuniteti më i gjerë ligjor (gjegj. Shoqatat e Avokatëve) në Evropë kanë punuar për të miratuar legjislacionin dhe për të organizuar veten në mënyrë që kjo e drejtë vitale ligjore të vihet në dispozicion të personave të varfër pa pagesë. E drejta për përfaqësues ligjor është me rëndësi të veçantë në **çështjet penale**, duke pasur parasysh vlerën e lartë që ne të gjithë e vendosim në lirinë tonë dhe stigmën që i ndryshon jetën dhe që i ngjitet qytetarit pas dënimit. Prandaj, si shtet më i ri nga këto shtete evropiane, Kosova është e detyruar të krijojë dhe zbatojë sisteme të tilla të ndihmës juridike në mënyrë që t'i përmbahet parimeve të përbashkëta për të drejta të njeriut të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

Në dhjetor të vitit 2016, Misioni i OSBE-së në Kosovë publikoi Monitorimin¹ e tyre vjetor të Drejtësisë, duke nxjerrë në pah – në mesin e shumë çështjeve tjera - mungesën e përfaqësimit ligjor të të pandehurve në procedurat penale në Departamentet e Përgjithshme të Gjykatave Themelore të Kosovës. Ky raport tërhoqi vëmendjen e Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD) dhe nxiti zbatimin e këtij projekti monitorues të dizajnuar për të ofruar të dhëna më të hollësishme dhe njohuri lidhur me besnikërinë e sektorit të drejtësisë në Kosovë ndaj obligimit të saj të bazuar në KEDNJ për të ofruar ndihmë juridike për të gjithë ata që nuk mund ta përballojnë atë.

Të dhënat e mbledhura përmes hulumtimeve sekondare, monitorimit të gjykimeve dhe intervistave me të pandehurit, gjyqtarët dhe avokatët do të demonstrojnë që përkundër faktit që ndihma juridike falas është një e drejtë e garantuar në Kushtetutën e Kosovës dhe instrumentet ndërkombëtare drejtpërdrejt të zbatueshme, Policia e Kosovës, prokurorët dhe gjykatat e Kosovës shpesh dështojnë që të identifikojnë dhe informojnë të pandehurit penal për të drejtën e tyre për përfaqësim juridik falas në rastet penale nën juridiksionin e Departamenteve të Përgjithshme të Gjykatave Themelore të monitoruara nga IKD. Si rezultat, këta qytetarë të akuzuar mbeten të pavetëdijshëm për këtë të drejtë vitale, dhe si rrjedhojë, avokatët e Kosovës nuk thirren siç duhet për të mbrojtur këta qytetarë të varfër.

Duke e ekspozuar këtë mungesë të sigurimit të ndihmës juridike falas në procedurën penale për të pandehurit, të cilët financiarisht nuk mund ta përballojnë një avokat, ky raport synon të rrisë vetëdijësimin e aktorëve relevantë për këtë shkëlqje serioze dhe të vazhdueshme të të drejtave të njeriut, dhe të propozojë rekomandime konkrete për institucionet shtetërore të Kosovës për të zhdukur këtë të metë në të dhënat e Kosovës për të drejtat e njeriut. Për më tepër, ky raport synon të informojë qytetarët e Kosovës

¹ Monitorimi i Drejtësisë i OSBE-së, korrik 2014- nëntor 2015, në dispozicion në: <http://www.osce.org/kosovo/208771?download=true>.

për të drejtën e tyre për ndihmë juridike falas të garantuar me Kushtetutën e Kosovës, KEDNJ-në dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), të zbatueshme drejtpërdrejt në Kosovë.

Gjetjet e raportit janë mbledhur nëpërmjet hulumtimit dhe monitorimit të seancave gjyqësore brenda divizioneve penale të Departamenteve të Përgjithshme të Gjykatave Themelore në Prishtinë, Pejë dhe Prizren. Monitorimi i gjykimeve - i kryer gjatë periudhës 1 shkurt - 31 maj 2017- u përqendrua në atë nëse të pandehurit u informuan në mënyrë adekuate për të drejtën e tyre për ndihmë juridike falas, ose kishin përfaqësues ligjor gjatë tërë procedurave përkatëse penale, në veçanti, kur ata nuk mund të përballonin financiarisht përfaqësimin.

2. METODOLOGJIA

Në këtë raport Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka përdorur metoda empirike dhe doktrinare për mbledhjen e të dhënave relevante në lidhje me zbatimin e detyrimeve kushtetuese dhe ligjore nga shteti për t'i siguruar të pandehurve qasje në një avokat të licencuar në çështjet penale në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatave Themelore në Prishtinë, Pejë dhe Prizren. Kjo metodologji hulumtuese u përzgjodh për të përcaktuar shkallën në të cilën gjykatat zbatuan detyrimet e tyre kushtetuese në lidhje me përfaqësimin ligjor të të pandehurve, duke përfshirë zbatimin e ndihmës juridike falas në këto raste.

2.1. HULUMTIMI PARAPRAK:

Gjatë janarit 2017, IKD-ja fillimisht zhvilloi takime me Kryetarin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe Drejtorin e Sekretariatit të KGJK-së, kryetarët e gjykatave dhe drejtuesit e Departamentit të Përgjithshëm të Gjykatave Themelore në Prishtinë, Pejë dhe Prizren për t'i informuar ata për projektin që IKD-ja ishte gati për ta zbatuar.

IKD-ja parashtroi kërkesa për qasje në dokumente publike në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Pejës dhe Prizrenit me qëllim të analizimit të tyre. Rastet, që datojnë që nga viti 2014, 2015 dhe 2016, janë zgjedhur rastësisht. IKD-ja po ashtu ka kryer hulumtime në lidhje me standardet e GJEDNJ-së, siç janë interpretuar dhe shpjeguar në vendimet ligjore të GJEDNJ-së në lidhje me të drejtën për ndihmë juridike falas në rastet penale.

2.2. MONITORIMI

Para monitorimit në Gjykatat Themelore të Prishtinës, Pejës dhe Prizrenit, IKD-ja zhvilloi një Doracak Monitorimi për stafin e IKD-së bazuar në udhëzimet e monitorimit të OSBE-së. Udhëzuesi drejtoi IKD-në në trajnimin e Monitoruesve në Terren të IKD-së, dhe më pas drejtoi monitoruesit gjatë gjithë punës së tyre në terren. Nga 1 shkurti deri më 31 maj 2017, IKD-ja monitoroi në mënyrë sistematike 524 seanca gjyqësore të procedurave penale në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatave Themelore në Prishtinë, Pejë dhe Prizren.

2.3. INTERVISTAT

Monitoruesit në terren intervistuan tridhjetë (30) të pandehur që iu nënshtruan procedurave penale para divizionit penal të Gjykatave Themelore dhe trembëdhjetë (13) gjyqtarë nga këto divizione në gjykatat e monitoruara.

2.4. ANALIZA E VENDIMEVE GJYQËSORE TË FORMËS SË PRERË

Bazuar në Ligjin për Qasje në Dokumente Publike, IKD-ja ka mundur të ketë qasje në 45 vendimet përfundimtare gjyqësore të zgjedhura në mënyrë të rastësishme të vitit 2014, 2015 dhe 2016 nga gjyqtarët e Divizionit Penal të Departamentit të Përgjithshëm të Gjykatave Themelore në Prishtinë, Pejë dhe Prizren. IKD-ja analizoi këto 45 vendime në mënyrë që të identifikojë veprat e pretenduara penale të adresuara nga gjykata, që të identifikojë dënimet e vendosura nga gjykata dhe që të analizojë praktikën e llogaritjes së shpenzimeve gjyqësore.

2.5 FOKUS GRUPI I PALËVE TË INTERESIT TË SISTEMIT TË DREJTËSISË

Më 22 maj 2017, IKD-ja mbajti një fokus grup me përfaqësues nga gjyqësori, prokuroria, Oda e Avokatëve të Kosovës, Avokati i Popullit, Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Ndihmën Juridike Falas dhe OJQ-të ku u diskutuan gjetjet paraprake të këtij raporti. Konkluzionet janë integruar në pjesën analitike të këtij raporti.

3. OFRIMI I NDIHMËS JURIDIKE NË KOSOVË: NJË KORNIZË LIGJORE E NDIKUAR NGA KEDNJ

3.1 KEDNJ DHE KUSHTETUTA E KOSOVËS

Sipas nenit 6 (1) të KEDNJ-së çdo person ka të drejtën “për një gjykim të drejtë...” në përcaktimin e të drejtave dhe obligimeve civile apo të ndonjë akuze penale...². Kjo nënkupton një shkallë e duhur e ‘barazisë së armëve’ duhet tu mundësohet të gjithë personave para një gjykate. ³ Në lidhje me veprat penale, neni 6 (3) (c) thotë që gjithkush ka të drejtë ‘të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t’i mundësohet ndihma juridike falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë.⁴

Përderisa neni 14 (3) (d) i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike garanton një të dretë të ngjajshme në përcaktimin e akuzave penale⁵.

Sipas Kushtetutës së Kosovës, këto dy dokumente ndërkombëtare janë drejtpërdrejt të aplikueshme në Kosovë dhe kanë epërsi mbi ligjet e Republikës së Kosovës⁶. Për më tepër, neni 53 i Kushtetutës përcakton se të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë interpretohen në përputhje me vendimet e GJEDNJ-së.⁷ Kjo dispozitë i obligon gjykatat në Kosovë që të udhëhiqen nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së.

Përveç kësaj, të njëjtat standarde të ndihmës juridike falas janë të mishëruara në nenin 30 (5) të Kushtetutës së Kosovës i cili parasheh që “Çdokush që akuzohet për veprë penale,... të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh...dhe, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme, t’i sigurohet mbrojtja falas.”⁸ Përmes procesit legjislativ, ligjvënësi ka pasur për qëllim të zbatojë dhe shtjellojë këtë të drejtë për ndihmë juridike në dy pjesë të veçanta të legjislacionit, përkatësisht Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPP) dhe Ligjit për Ndihmë Juridike Falas (NJF).

² Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në dispozicion në: http://www.echr.coe.int/Documents/Convention_ENG.pdf.

³ *Po aty*.

⁴ *Po aty*.

⁵ Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, në dispozicion në: <https://treaties.un.org/doc/publication/unts/volume%20999/volume-999-i-14668-english.pdf>.

⁶ Neni 22 i Kushtetutës i është nënshtruar detyrimeve të njëanshme në lidhje me Zbatimin e Drejtpërdrejtë të Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare. Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare të mëposhtme janë të garantuara me këtë Kushtetutë, të zbatuara drejtpërsëdrejti në Republikën e Kosovës dhe kanë përparësi, në rast konflikti, ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike. (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollit e saj; (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollit e saj.

⁷ Neni 53 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, 15 qershor 2008, në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>.

⁸ *Po aty*, neni 30.

3.2 KODI I PROCEDURËS PENALE DHE E DREJTA PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

KPP-ja në thelb adreson të drejtën për ndihmë juridike falas në dy nene të veçanta të emërtuara si Mbrojtje e detyruar (Neni 57)⁹ dhe si “Mbrojtje jo e detyruar (neni 58).¹⁰ Neni 57 i KPP-së në mënyrë eksplicite përcakton rrethanat në të cilat një i pandehur ka të drejtë në mbrojtës me shpenzime publike: kur i pandehuri është dëmtuar¹¹,“ gjatë seancës për caktimin e paraburgimit dhe gjatë kohës derisa ai gjendet në paraburgim; kur aktakuza është ngritur kundër tij për vepër penale të dënueshme me të paktën 10 (dhjetë) vjet burgim dhe në të gjitha rastet kur i pandehuri kërkon të hyjë në marrëveshje për pranimin e fajësisë për vepër penale për të cilën parashihet dënim i gjatë me së paku një (1) vit burgim¹².

Në të gjitha këto raste, nëse i pandehuri nuk angazhon mbrojtës, është obligim i gjykatës ose një organi tjetër kompetent të caktojë një mbrojtës sipas detyrës zyrtare me shpenzime publike¹³. Zbatimi i kësaj dispozite në praktikë është duke u bërë vazhdimisht. Sipas gjyqtarit Naser Foniqi, Udhëheqësi i Divizionit Penal në Departamentin e Përgjithshëm në Gjykatën Themelore në Prishtinë, sa herë që i pandehuri nuk ka përfaqësim ligjor dhe dënimi për veprën sipas KPP-së është me natyrë serioze, ai personalisht u kujdes për të informuar të pandehurit për të drejtat e tyre të përcaktuara me nenin 57 të KPP-së, në veçanti të drejtën e tyre për të kërkuar nga Gjykata të caktojë përfaqësimin e ashtuquajtur “sipas detyrës zyrtare”¹⁴.

Ndërkohë, Neni 58 i KPP-së zgjeron fushën e aplikimit për caktimin e avokatit mbrojtës me shpenzime publike edhe në rastet kur ‘procedura penale zhvillohet për vepër penale për të cilën është paraparë dënimi me burgim me tetë (8) ose më shumë vjet, ose, kur këtë e kërkojnë *‘interesat e drejtësisë pavarësisht nga dënimi parashikuar... në qoftë se sipas gjendjes pasurore të tij/saj nuk mund t’i përballojë shpenzimet e mbrojtjes së tij.’* (theks i shtuar).¹⁵ IKD-ja duhet të theksojë se në hartimin e kësaj fraze, Parlamenti i Kosovës sipas detyrës, në mënyrë identike ka ndjekur gjuhën e nenit 6.3 (c) të KEDNJ-së, duke demonstruar një synim legjislativ të qartë për të siguruar që të gjithë aktorët e sektorit të drejtësisë t’i përmbahen standardeve të nenit 6 të KEDNJ-së në trajtimin e të pandehurve të akuzuar për krime që parashohin dënime me burgim më të vogël se 8 vjet.

⁹ Neni 57 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Nr. 04 /L-123, në dispozicion në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>.

¹⁰ *Po aty*, neni 58.

¹¹ KPP neni 57 parasheh që i pandehuri duhet të ketë mbrojtës “kur i pandehuri është memec, shurdh, i verbër ose shpreh shenja të çrregullimeve apo paaftësisë mendore dhe kështu është i paaftë që të mbrohet vetë me sukses ...”.

¹² *Po aty*.

¹³ *Po aty*, neni 57, para 2.

¹⁴ Intervistë për emisionin televiziv “Betimi për Drejtësi”, Mjetet juridike efektive, i transmetuar më 16 qershor 2017, në Radio Televizionin e Kosovës, në dispozicion në: <http://betimiperdrejtesi.com/emisionet/mbrojtja-efektive-juridike>.

¹⁵ KPK neni 58.

Lidhur me informimin e të pandehurve për këtë të drejtë për avokat, KPP neni 58 (2) nuk identifikon në mënyrë të qartë aktorin shtetëror të detyruar të japë këtë informatë. Neni 58 (2) thjesht thekson se "I pandehuri njoftohet për të drejtën e tij në mbrojtës me shpenzime publike sipas paragrafit paraprak para se të merret në pyetje për herë të parë¹⁶. Në intervistat me të pandehurit penalë të intervistuar nga IKD-ja, është bërë e qartë se, në pothuaj të gjitha rastet, të pandehurit nuk ishin të informuar për këtë të drejtë.

Megjithëse kërkesa e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së kërkon qartë që gjyqtarët të ushtrojnë kontroll mbi procedurat penale dhe t'u sigurojnë të gjitha palëve "*barazi të armëve*¹⁷" në këto procedura, gjuha e tanishme e KPP-së në mënyrë të papërshtatshme vendos barrën për të kërkuar emërimin e mbrojtësit me shpenzime publike mbi të pandehurin e varfër.¹⁸ Më pas, një kërkesë e tillë aprovohet nga gjykata ose autoriteti tjetër kompetent (gjegj. Policia, Prokuroria) në varësi të fazës së rastit në procedurë¹⁹ dhe vetëm atëherë i pandehuri është i detyruar të plotësojë një deklaratë që tregon pasuritë e veta dhe deklaron se ai ose ajo nuk mund ta përballojë mbrojtësin ligjor²⁰.

3.3 LIGJI PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

Ligji për Ndhmë Juridike Falas (NJF) krijon sistemin e ndihmës juridike falas në Kosovë, duke përfshirë ndihmën juridike në procedurën penale²¹. NJF krijon Agjencinë e Ndhmës Juridike Falas dhe përcakton kriteret që qytetarët duhet të përmbushin për të marrë ndihmë juridike falas (kriteri kualifikues, kriteret financiare dhe ligjore)²². Megjithatë, ndryshe nga KPP, Ligji për NJF nuk bën dallim në mes të rasteve penale sipas detyrës zyrtare që kërkojnë përfaqësim të detyrueshëm penal (KPP neni 57) dhe përfaqësimit penal diskrecional (KPP neni 58). Në vend të kësaj, neni 4, par. 2 i LNJF kërkon përfaqësim penal *në të gjitha fazat e procedurës penale pavarësisht nga numri i viteve të burgimit të mundshëm*, përderisa të gjitha kualifikimet e përcaktuara në LNJF neni 6 janë plotësuar²³. Shkurtimeisht, si duket gjuha diskrecionale e KPP-së në nenin 58 (2), që i udhëzon gjyqtarët për të siguruar mbrojtës ligjor për të pandehurit e varfër për krimet për të cilat parashihen dënime nën 8 vjet duket se janë shkurtuar rëndë nga gjuha e detyrueshme e LNJF neni 4 (2) - i cili jo vetëm që u siguron të pandehurve të varfër një mbrojtës ligjor falas kur akuzohen për vepra që parashihen dënime të

¹⁶ *Po aty*, Article 58, para 2.

¹⁷ Timergaliyev kundër Rusisë (<http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-88888>). Dështimi i një avokati të paraqitet në procedurën e ankesës dhe vendimi i një gjykate për të shqyrtuar rastin megjithatë, ka shkelur Art. 6 në lidhje me nenin 6-3 (c) të KEDNJ-së. Në këtë vendim, Gjykata Timergaliyev shtjellon konceptin se gjyqtari është "kujdestari kryesor i procedurës" dhe kështu një detyrim pozitiv (motivi i drejtësisë) për të vepruar për të parandaluar pabarazinë e armëve të shkaktuar nga mungesa e avokatit të të pandehurit.

¹⁸ *Po aty*.

¹⁹ *Po aty*, Neni 58, para. 3.

²⁰ *Po aty*, Neni 58, para. 4.

²¹ Article 1, of the Free Legal Aid Law, No. 04/L-017, available at <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2803>.

²² *Po aty*, Neni 6.

²³ *Po aty*, Neni 4, para 2.

shkurtra burgimi, por gjithashtu siguron përfaqësim për krime të pretenduara për të cilat nuk parashihet asnjë dënim, duke përfshirë kundërvajtjet²⁴.

Duke pasur parasysh objektin e saktë të çështjes së ligjit për NJF, fokusin e ligjit në ruajtjen e të drejtave të njeriut dhe parimin e Lex Specialis, të gjitha gjykatat e Kosovës janë të detyruara të sigurojnë mbrojtës ligjor për të pandehurit e varfër “në interes të drejtësisë” në çdo rast penal dhe kundërvajtje pa marrë parasysh gjatësinë e dënimit të mundshëm²⁵. Në mënyrë të ngjashme, duke pasur parasysh rëndësinë e ruajtjes së të drejtave të të akuzuarve në procedurë të hershme, prokurorët dhe policia janë po aq të detyruar të ushtrojnë autoritetin e tyre në përputhje me nenin. 4 të LNJF²⁶.

3.4 PRAKTIKA GJYQËSORE E GJEDNJ-SË: KRITERI “FINANCIAR” DHE “INTERESI I DREJTËSISË”

Edhe nëse gjyqtarët e Kosovës e refuzojnë argumentin e Lex Specialis të përmendur më sipër, dhe e injorojnë gjuhën e LNJF duke iu përmbajtur gjuhës së nenit 58 (2) të KPP-së, ata kanë një detyrim të rreptë për të ushtruar diskrecionin e nenit 58 në një mënyrë që nuk shkel të drejtën e të pandehurit në mbrojtës ligjor që rrjedh nga neni 6 i KEDNJ-së së. A duhet të ndjekin këtë rrugë alternative, ne paraqesim se ata do ta gjejnë veten nën një obligim të ngjashëm për të siguruar mbrojtës.

Siç është paraqitur më lart, neni 58 i KPP-së në mënyrë specifike i referohet kriterëve nenit 6 të KEDNJ-së në tekstin e tij “financiar” (mjete të mjaftueshme) dhe “interes i drejtësisë”. Megjithatë, meqë këto koncepte nuk janë përcaktuar ose interpretuar në mënyrë të duhur në ndonjë vendim individual të gjykatës së Kosovës, duhet t'i drejtohem praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së për udhëzime.

Për të marrë ndihmë juridike falas GJEDNJ merr parasysh a) mjetet e mjaftueshme të personit për të paguar ndihmën juridike dhe b) “interesin e drejtësisë”.²⁷

Sa i përket kriterëve financiare, autoritetet vendore janë të detyruara të përcaktojnë pragun financiar siç e gjykojnë të arsyeshme, për sa kohë që vendimi për përshtatshmërinë financiare për ndihmë juridike bazohet në ligj dhe jo në bazë

²⁴ *Po aty*.

²⁵ Shih Besa Arifi & Dr Dennis Farrington, Pro Bono Ndihma Juridike, Universiteti i Evropës Juglindore (2012) (në tekstin e mëtuajtshëm Ndihma Juridike). Ky hulumtim ofron një diskutim të ngjashëm të lex specialis që përfshin ndihmën juridike falas në procedurën penale të Republikës së Maqedonisë në përputhje me KEDNJ, ku e para i përmbahet më tej kërkesave të KEDNJ-së Neni 6.3 (c), 3.6 pg 46, https://www.seeu.edu.mk/files/research/ProBono_LegalAid.pdf (në vazhdim: Ndihma Juridike).

²⁶ *Po aty*, në Pjesën 3.7, fq. 47, ku autorët angazhohen në një pasqyrë të shkëlqyer të të gjitha "fazave kritike" që në fillim të procedurës penale, që sipas praktikës së GJEDNJ, kërkojnë që i pandehuri të ketë mbështetjen e përfaqësuesit ligjor.

²⁷ Rasti i *Quaranta kundër Zvicrës*, nr. 12744/87, i datës 24 maj 1991, në dispozicion në: [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"appno":\["12744/87"\],"itemid":\["001-57677"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{) (në tekstin e mëtejshëm: *Quaranta*).

arbitrare.²⁸ Megjithatë, gjatë përcaktimit të mjeteve financiare të një të pandehuri në rastin e Pakellit kundër Gjermanisë, GJEDNJ vendosi që mungesa e mjeteve të mjaftueshme për të paguar ndihmën juridike të të pandehurit nuk kërkohet të vërtetohet “përtej çdo dyshimi”. Bërthama financiare e testit plotësohet nëse ka “disa indikacione” se një i pandehur është i varfër dhe nuk ka “tregues të qartë për të kundërtën”.²⁹ Fatmirësisht, Kosova ka krijuar tashmë një kriter racional fiskal, të bazuar në politika, për Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas për të konfirmuar “nevojën fiskale” midis përfituesve potencialë të NJF që duket se përfshijnë më shumë se gjysmën e popullsisë.³⁰ Sidoqoftë, Avokati i Popullit i Kosovës ka theksuar se qeveria siguron vetëm një pjesë të fondeve të nevojshme për të paguar mbrojtësin ligjor në një mënyrë në pajtim me ligjin e NJF.³¹

Sa i përket kriterëve të “interesit të drejtësisë”, sipas GJEDNJ-së, kriteret e “interesit të drejtësisë” kërkojnë përmbushjen e kushteve të caktuara siç janë: (1) serioziteti i veprës; (2) kompleksitetin e çështjes; dhe (3) aftësia e të pandehurit për të siguruar përfaqësimin e tij/saj.³² Këto kushte u caktuan nga gjykata në rastin Quaranta kundër Zvicrës, ku parashtruesi u akuzua për përdorim të drogës dhe trafikim dhe u dënua me burgim (jo më shumë se tre vjet) ose gjobë.³³ Gjykata konstatoi se kishte shkelje të nenit 6 (3) (c) sepse interesat e drejtësisë kërkonin që parashtruesve t’u sigurohej ndihmë juridike falas gjatë paraqitjeve para gjyqtarit hetues dhe në gjykim pasi që paraqitja e tij personalisht pa ndihmën e një avokati nuk i mundësoi atij të paraqesë rastin e tij në mënyrë adekuate.³⁴ Në bazë të *Quaranta*, GJEDNJ ka ndërtuar standardin që siguron e drejta për ndihmë juridike falas kur një dënim i mundshëm mund të vendoset nga gjykata pas dënimit. Shkurtimisht, obligimi i Shtetit për të siguruar mbrojtje penale ndaj të pandehurit të varfër lind kur një i pandehur rrezikon burgimin.³⁵ Sa i përket kriterit të “kompleksivitetit të çështjes”, në sistemin adversial që mbështetet në egzaminimin e kryqëzuar sikur që ekziston në Kosovë. Kompleksiviteti ekziston pasi që aftësitë e mbrojtësit të të pandehurit duhet të jenë të atij niveli që përkon me aftësitë e prokurorit të rastit dhe kështu të ruhet një barazi e armëve³⁶.

²⁸ Rasti i Pakellit kundër Gjermanisë, kërkesa nr.8398/78, i datës 28 prill 1983, në dispozicion në [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"appno":\["8398/78"\],"itemid":\["001-57554"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{) (në tekstin e mëtejshëm: *Pakelli*).

²⁹ *Po aty*. Gjykata Pakelli u mbështet në “disa indikacione” se parashtruesi nuk ishte në gjendje të paguante avokatin e tij, duke përfshirë deklaratat lidhur me tatimin dhe faktin që parashtruesi kishte kaluar dy vitet e mëparshme në parburgim, ndërsa ankesa e tij në pikat e ligjit ishte në pritje.

³⁰ LNJF Neni 8 (. të gjithë personat, të ardhurat bruto të familjes, janë më të ulëta se të ardhurat mesatare të familjes)

³¹ Intervistë me z. Hilmi Jashari, Intervistë, për televizionin “Betimi për Drejtësi” Mjetet juridike efektive, të transmetuar më 16 qershor 2017 në Radio Televizionin e Kosovës, në dispozicion në: <http://betimiperdrejtesi.com/emisionet/mbrojtja-efektive-juridike/>.

³² *Rasti i Quaranta kundër Zvicrës*, nr. 12744/87, i datës 24 maj 1991, në dispozicion në: [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"appno":\["12744/87"\],"itemid":\["001-57677"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{) (në tekstin e mëtejshëm: *Quaranta*).

³³ *Po aty*.

³⁴ *Po aty*.

³⁵ Rasti Quaranta kundër Zvicrës, nr. 12744/87, i 24 majit 1991, në dispozicion në: [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"appno":\["12744/87"\],"itemid":\["001-57677"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{).

³⁶ Ndhima Juridike seksioni 3.2, faqe 41.

GJEDNJ gjithashtu e bën të qartë se gjykatat kanë një obligim pozitiv për të mbrojtur të drejtat e të pandehurit nga neni 6 GJEDNJ-së duke siguruar “barazinë e armëve” në procedurat penale. Siç tregohet në rastin e *Artico*, ky detyrim përfshin nevojën që gjykatat të fillojnë procedurat disiplinore ndaj avokatëve që nuk kryejnë përgjegjësitë e tyre.³⁷

4. MEKANIZMAT PËR OFRIMIN E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Agjencia për Ndhmë Juridike Falas³⁸ u krijua në maj të vitit 2006 dhe ka mandatin për të ofruar dhe siguruar qasje të barabartë në drejtësi për qytetarët e Republikës së Kosovës, në promovimin, respektimin dhe mbrojtjen e parimeve të të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit në Kosovë³⁹.

Sipas Ligjit të NJF, Republika e Kosovës ushtron veprimtarinë e saj si një organ i pavarur përgjegjës për sigurimin e ndihmës juridike falas në fushat civile, penale, administrative dhe për kundërvajtje për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilëve u është mohuar qasja në drejtësi, për shkak të mungesës së mjeteve financiare dhe që plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj. Ndhma juridike falas u jepet të gjithë personave, të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj në procedurat penale, civile dhe administrative. Megjithatë, për shkak të dështimit të shtetit për të ndarë buxhet të mjaftueshëm për të zbatuar ligjin e NJF në ofrimin e ndihmës juridike në rastet penale. Agjencia nuk ka fonde për të ofruar ndihmë juridike në rastet penale, dhe fondet qeveritare shfrytëzohen vetëm për ofrimin e ndihmës juridike në rastet civile dhe administrative. Fondet janë shumë të kufizuara dhe Agjencia rrezikon të mbyllet.⁴⁰

Përkundër mandatit të ofrimit të ndihmës juridike penale nga Agjencia që nga viti 2006, Parlamenti ka vazhduar të japë fonde për ndihmë juridike penale në buxhetet e gjykatave dhe prokurorëve për shpërndarje.⁴¹ Kjo në mënyrë efektive i ka mbajtur gjykatat dhe prokurorët përgjegjës për kompensimin e të gjitha shpenzimeve të gjykatës lidhur me përfaqësimin ligjor në rastet penale të kryera nga avokatët.

³⁷Rasti *Artico* kundër Italisë, nr. 6694/74, i datës 13 maj 1980, [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"dmdocnumber":\["695301"\],"itemid":\["001-57424"\]}.](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

³⁸ Më shumë rreth Agjencisë për Ndhmë Juridike Falas ju mund të gjeni në: <http://www.anjf-rks.net/>.

³⁹ Ndhma Juridike Falas, Nr. 04/L-017, në dispozicion në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2803>.

⁴⁰ Udhëheqësi i Agjencisë së Ndhmës Juridike Falas paraqitet para Komisionit për Legjislacion të Kuvendit të Kosovës, 19 prill 2016, lajmi televiziv TV Rrokum, në dispozicion në: <http://www.rrokum.tv/lajme/agjencia-per-ndihme-juridike-falas-rrezikon-me-u-mbyll/>.

⁴¹ Ligji për Buxhetin e Kosovës (2006-2017).

5. PRAKTIKA AKTUALE E KOSOVËS E NDIHMËS JURIDIKE FALAS NË PROCEDURA PENALE

Gjykata Themelore - Prishtinë

Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal

Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në Prishtinë aktualisht ka tridhjetë e dy (32) gjyqtarë, nga të cilët tetë (8) janë brenda Divizionit Penal. Më 1 janar 2017, Divizioni Penal i Gjykatës Themelore të Prishtinës kishte gjithsej 13,568 lëndë në procedurë. Numri mesatar i lëndëve për gjyqtarë është 1707.

Gjykata Themelore - Pejë

Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal

Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në Pejë aktualisht ka shtatëmbëdhjetë (17) gjyqtarë, nga të cilët pesë (5) janë në Divizionin Penal. Më 1 janar 2017, Divizioni Penal i Gjykatës Themelore të Pejës kishte gjithsej 1739 lëndë në procedurë. Numri mesatar i lëndëve për gjyqtarë është 580.

Gjykata Themelore -Prizren

Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal

Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në Prizren aktualisht ka njëzet e tre (23) gjyqtarë, nga të cilët tetë (8) janë brenda Divizionit Penal. Më 1 janar 2017, Divizioni Penal i Gjykatës Themelore të Prizrenit kishte gjithsej 3832 lëndë në procedurë. Numri mesatar i lëndëve për gjyqtarë është 479.
















Gjykata / Divizioni Penal	Numri i gjyqtarëve	Numri i lëndëve	Numri mesatar i lëndëve për gjyqtar	Numri i popullsisë
 Prishtinë	 8	 13.568	 1707	 470.583
 Pejë	 5	 1739	 580	 277.007
 Prizren	 8	 3.832	 479	 371.770

Tabela 1: Statistikat e përgjithshme në lidhje me Divizionin Penal të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Pejë dhe Prizren më 1 janar 2017.

5.1 GJETJET E MONITORIMIT DHE SITUATA NË PRAKTIKË

Nga 1 shkurti deri më 31 maj 2017, IKD monitoroi gjithsej **524** seanca gjyqësore⁴² në Divizionin Penal të Departamentit të Përgjithshëm në Gjykatat Themelore të Prishtinës, Pejës dhe Prizrenit. Në GJTH të Prishtinës, janë monitoruar gjithsej 197 seanca gjyqësore, ndërsa në Pejë janë monitoruar gjithsej 141 seanca gjyqësore, dhe në GJTH Prizren janë monitoruar gjithsej 186 seanca gjyqësore. Tabela më poshtë tregon numrin e përgjithshëm të seancave gjyqësore të monitoruara, të mbajtura dhe atyre të shtyra.




Gjykatat Themelore Departamentet e Përgjithshme / Divizionet Penale	Numri i seancave të planifikuara 	Numri i seancave të mbajtura 	Numri i seancave të shtyra 
Prishtinë	197	141	56
Pejë	141	82	59
Prizren	186	86	90
Total	524	319	205

Tabela 2: Statistikat mbi seancat e monitoruara.

Në total, 667 të pandehur iu nënshtruan procedimeve penale në 524 seanca gjyqësore të monitoruara. Nga 667 të pandehur, 457 (68.51%) prej tyre nuk kishin asnjë përfaqësim ligjor, ndërsa 163 (31.49%) të pandehur kishin përfaqësim ligjor. Këto të dhëna janë paraqitur në Tabelën 3 më poshtë.

⁴² Përmbledhjet e raporteve të monitorimit për secilën seancë gjyqësore në Divizionet Penale të Gjykatave Themelore në Prishtinë, Pejë dhe Prizren postohen çdo ditë në ueb faqen “Betimi për Drejtësi”, në dispozicion në: www.betimiperdrejtesi.com.






Gjykatat Themelore Departamentet e Përgjithshme / Divizionet Penale	Numri total i të pandehurve	Numri i të pandehurve me avokat	Numri i të pandehurve pa avokat	Numri i të pandehurve që paguan avokatin e tyre	Numri i të pandehurve që kanë marrë avokat falas (sipas detyrës zyrtare)
					
Prishtinë	254	89	165	77	12
Pejë	172	32	112	25	7
Prizren	241	42	180	29	13
Total	667	163	457	131	32

Tabela 3: Statistikat e monitorimit të ndara sipas përfaqësimit të të pandehurve me/pa avokatë.

Statistikat dëshmojnë se në lëndët e departamenteve të krimeve të përgjithshme, shumica e të pandehurve nuk kanë pasur përfaqësim ligjor. Në 163 lëndë kur të pandehurit kanë pasur përfaqësim ligjor, vetëm 20% kanë marrë ndihmë juridike, ndërsa 80% e këtyre të pandehurve kanë paguar për mbrojtjen e tyre. Në praktikë, ndihma juridike falas në rastet e krimeve të përgjithshme ofrohet sipas detyrës zyrtare vetëm kur plotësohen kriteret e nenit 57 (d.m.th. seancat paraprake të paraburgimit), por shumë rrallë ofrohen si ndihmë juridike falas me diskrecion (Neni 58). Si rezultat, mostra jonë tregon se vetëm 32 prej 667 të pandehurve në lëndët e departamenteve të krimeve të përgjithshme kanë marrë mbrojtës ligjor me shpenzime publike.

IKD pati mundësinë të mbledhë të dhëna mbi gjendjen financiare të 379 të pandehurve gjatë fazës së monitorimit. Nga kjo mostër e vogël, gjithsej 116 të pandehur (30%) deklaruan se kanë të ardhura të ulëta ose që janë nën skemën e mirëqenies sociale në 3 gjykatat e monitoruara.






Gjykatat e monitoruara	Të pandehurit me të ardhura të ulëta	Të pandehurit me të ardhura mesatare	Të pandehurit me të ardhura të mjaftueshme	Të pasur	Nën skemën e pensioneve të Ndhmës Sociale	Pa informata
						?
Prishtinë	32	68	0	0	2	10
Pejë	14	82	3	1	15	3
Prizren	52	38	4	1	1	53
Total	98	188	7	2	18	66

Tabela 4: Statistikat e monitorimit të ndara sipas statusit financiar të të pandehurve.

5.2 TË DHËNAT E MBLËDHURA NGA INTERVISTAT E TË PANDEHURVE

Monitoruesit e IKD në terren intervistuan 30 të pandehur, që kanë kaluar nëpër procedura penale në Gjykatat Themelore të Prishtinës, Pejës dhe Prizrenit.⁴³ Nga këta 30 të pandehur, dymbëdhjetë (12) vinin nga familje me të ardhura të ulëta, njëmbëdhjetë (11) nga familjet me të ardhura mesatare, dy (2) prej familjeve me të ardhura të mira. Së fundi, dy (2) të pandehur ishin në ndihmë sociale, duke e çuar numrin e përgjithshëm të të pandehurve të pranueshëm sipas NJF, Neni 4 në këtë mostër interviste në 14 nga 30 (46%). Nga tridhjetë të pandehur vetëm tetë (8) kishin përfaqësim ligjor prej të cilëve gjashtë (6) u ishin dhënë autorizime dhe dy (2) ishin sipas detyrës zyrtare (përfaqësim ligjor falas).

Nga të pandehurit me ndihma sociale vetëm njërit i ishte siguruar përfaqësim sipas detyrës zyrtare, ndërsa tjetri kishte angazhuar përfaqësimin ligjor sipas autorizimit (financim vetanak). I pandehuri nr. 4 shpjegoi se atij nuk i është ofruar përfaqësim ligjor gjatë intervistimit të policisë dhe se ai nuk ishte në dijeni se ai kishte të drejtën e një avokati gjatë intervistës. Më pas, ai u arrestua dhe u mbajt për 48 orë. Ky është një fakt

⁴³ Pyetësi i IKD për të Pandehurit, Intervista përmbante gjithsej gjashtëmbëdhjetë pyetje. Pyetjet për intervistat u transferuan pastaj në një analizë tematike për të mbledhur informacionin përkatës. Analiza tematike u përqendrua në: 1. gjini; 2. gjendje ekonomike; 3. profesion; 4. vepra/dënime penale; nëse ishte bërë arrestimi; nëse kishte pasur përfaqësim ligjor gjatë marrjes në pyetje të policisë, ose gjatë ndjekjes penale dhe paraqitjes në gjykim/gjykatë; 5. nëse përfaqësimi ligjor ishte bërë direkt nga i pandehuri ose nëpërmjet Nenit 57 ose 58 të KPPRK.

alarmues dhe shkelje e nenit 11, paragrafit 5 dhe 6⁴⁴ dhe nenit 53, paragrafit 2⁴⁵ të Procedurës Penale të Kosovës. Për më tepër, është shkelje e nenit 6, paragrafit 3 (c)⁴⁶.

Për më tepër, nga numri i përgjithshëm i 30 të pandehurve, tetë (8) u arrestuan dhe vetëm dy (2) kishin përfaqësim ligjor gjatë marrjes në pyetje/intervistave të policisë. Rrjedhimisht, nga tridhjetë të pandehur, vetëm tre (3) kishin përfaqësim ligjor gjatë intervistimit/marrjes në pyetje nga prokurorët.

Intervistat e IKD-së për të Pandehurit tregojnë se shumë të pandehur nuk janë vënë në dijeni as për të drejtën e tyre sipas KPPRP, Neni 58 (2) "të kërkojë mbrojtës me shpenzime publike", ose për të drejtën për ndihmë juridike falas sipas NJF, Neni 4. Është alarmues fakti se pasi u njoftuan për këtë të drejtë themelore gjatë intervistave të IKD-së, shumica e të pandehurve të intervistuar - duke besuar në pafajësinë e tyre - deklaruan se nuk kanë nevojë për një avokat sepse ata ose besonin në pafajësinë e tyre ose sepse besonin se mund të mbrojnë më mirë veten e tyre. Kështu, jo vetëm që gjykatat dështojnë të mbrojnë të drejtat kushtetuese të të pandehurit, por intervistat e IKD-së zbulojnë një nivel të rrezikshëm të *analfabetizmit për të drejtat*, veçanërisht duke pasur parasysh miratimin e fundit të një sistemi të drejtësisë penale kundërshtuese të Kosovës.

5.3 INTERVISTAT ME GJYQTARËT

Monitoruesit në terren të IKD-së intervistuan 13 gjyqtarë nga Departamentet e Përgjithshme të Gjykatave Themelore në Prishtinë, Pejë dhe Prizren⁴⁷ lidhur me përfaqësimin e të pandehurve me avokat mbrojtës në Divizionet Penale dhe zbatimin e ndihmës juridike falas në gjykata. Gjyqtarët gjatë këtyre intervistave u morën në pyetje lidhur me: 1. numrin e lëndëve për gjyqtar të caktuar ose në procedurë; 2. nëse në praktikë të pandehurit kanë përfaqësim ligjor; 3. nëse është e zakonshme që të pandehurit të kërkojnë përfaqësim sipas detyrës zyrtare; 4. nëse, sipas mendimit të tyre, mungesa e përfaqësimit ligjor ndikon në cilësinë e procedurave gjyqësore dhe/ose të drejtat e të pandehurve.

⁴⁴ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës - Neni 11 - Përshtatshmëria e Mbrojtjes - paragrafi 5. Në shqyrtimin e parë, gjykata ose organi kompetent i cili e drejton procedurën penale detyrohet ta njoftojë të pandehurin për të drejtën e tij/saj në mbrojtës që nga marrja në pyetje për herë të parë, ashtu siç parashihet me këtë Kod. Paragrafi 6. Në pajtim me dispozitat e këtij Kodi, çdo person i privuar nga liria ka të drejtë në shërbimet e mbrojtësit që nga arresti e tutje.

⁴⁵ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës - Neni 53 paragrafi 2 - Para çdo marrjeje në pyetje të të dyshuarit ose të pandehurit, policia ose organi tjetër kompetent, prokurori i shtetit, gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues udhëzon të dyshuarin ose të pandehurin për të drejtën e tij në angazhimin e mbrojtësit dhe se mbrojtësi mund të marrë pjesë gjatë marrjes së tij në pyetje.

⁴⁶ KEDNJ Neni 6 par. 3 (c) të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë.

⁴⁷Shtojca 2, intervista me gjyqtarë.

Pyetësi i IKD-së konfirmoi se vlerësimi i secilit gjyqtar në lidhje me madhësinë substanciale të ngarkesës të tyre përkatëse me lëndë ishte në pajtim me statistikat zyrtare të mbledhura nga IKD nga gjykata (shih tabelën 4 më poshtë).




Tabela 4: Statistikat për rastet që secili gjyqtar i intervistuar ka në punë.

Të gjithë gjyqtarët e intervistuar nga IKD pranojnë rëndësinë që të pandehurit të kenë përfaqësim ligjor në të gjitha fazat e procedimeve penale.⁴⁸ Megjithatë, secili gjyqtar i intervistuar konfirmoi saktësinë e të dhënave të monitorimit të IKD-së, duke deklaruar se vetëm një mesatare prej 5-10% e të pandehurve kërkojnë përfaqësim ligjor falas.⁴⁹ Sidoqoftë, secili gjyqtar ofroi një sërë arsyesh praktike pse gjykatat nuk arrijnë të ofrojnë ndihmë ligjore falas për të pandehurit e varfër në lëndët e krimit të përgjithshëm.⁵⁰

Së pari, sipas gjyqtarëve, KPPRK obligon gjyqtarët që të caktojnë mbrojtës me shpenzime publike vetëm në rastet e mbrojtjes së detyrueshme, siç parashihet me nenin 58 të KPPRK.⁵¹ Së dyti, gjyqtarët pohojnë se nuk kanë një buxhet të mjaftueshëm për të qenë në gjendje të caktojë mbrojtësin me shpenzime publike për lëndët e krimit të përgjithshëm.⁵² Në mënyrë të veçantë, disa gjyqtarë kanë raportuar se kanë “kufizime në lidhje me fondet që shpërndahen nga KGJK-ja në lidhje me përfaqësimin ligjor”.⁵³ Prandaj, gjykatat udhëzohen të mos angazhojnë avokatë përveç rasteve që janë të detyrueshme.⁵⁴ Së treti, sa i përket aspektit të pazbatuar të Ligjit të NJF (shih infra Seksioni 3 (c)), gjyqtarët nuk i referojnë të pandehurit në shërbimet e Agjencisë së Ndihmës Juridike Falas sepse ata janë të vetëdijshtëm se Agjencia gjithashtu ka probleme me çështjet e financimit.⁵⁵ Së fundi, por jo më pak e rëndësishme, gjyqtarët u pajtuan me shqetësimet e shoqërisë civile që të ardhurat e ulëta ose të pandehurit e varfër nuk kërkojnë mbrojtës me shpenzime publike sepse mbeten analfabetë në lidhje me këtë të drejtë të mbrojtur nga KEDNJ.⁵⁶

Sa i përket cilësisë së mbrojtjes ligjore, një numër i konsiderueshëm (4) prej 13 gjyqtarëve të intervistuar shprehën shqetësime të mëdha për cilësinë e mbrojtjes penale të ofruar nga avokatët e OAK dhe sugjeruan që të pandehurit shërbehen më mirë duke mos pasur një avokat të pranishëm.⁵⁷ Megjithatë, nëntë (9) gjyqtarë të tjerë kanë deklaruar se ofrimi i përfaqësimit ligjor i mundëson të pandehurit të kuptojë më mirë të

⁴⁸ *Intervistat individuale të gjyqtarëve*. Shih gjithashtu, Intervistë me Naser Foniqi, Udhëheqës i Divizionit Penal në Departamentin e Përgjithshëm në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Kreshnik Radoniqi, Kryetar i Gjykatës Themelore në Pejë dhe Teuta Krusha, Udhëheqëse e Divizionit Penal në Departamentin e Përgjithshëm në Gjykatën Themelore në Prizren, për TV “Betim për Drejtësi”, Mjetet juridike efektive, të transmetuar më 16 qershor 2017, në Radio Televizionin e Kosovës, në dispozicion në: <http://betimiperdrejtesi.com/emisionet/mbrojtja-efektive-juridike/>.

⁴⁹ Në rastet kur kërkohet ndihmë juridike falas, gjyqtarët konfirmuan që të pandehurit duhet të dëshmojnë se kanë të drejtë për ndihmë juridike falas.

⁵⁰ *Po aty*.

⁵¹ *Po aty*, Intervistë me Kreshnik Radoniqin, Kryetar i Gjykatës Themelore në Pejë.

⁵² *Po aty*, *Fokus Grupi u mbajt më 22 maj 2017 me gjyqtarët, prokurorët, avokatët dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile*.

⁵³ *Po aty*.

⁵⁴ *Po aty*.

⁵⁵ *Po aty*.

⁵⁶ *Po aty*, Intervistat me të pandehurit, grupi i fokusit i mbajtur më 22 maj 2017 me gjyqtarë, prokurorë, avokatë dhe përfaqësues të Shoqërisë Civile.

⁵⁷ *Intervistat individuale të gjyqtarëve*, Katër (4) nga trembëdhjetë (13) gjyqtarë shprehën shqetësimet e tyre me përfaqësimin ligjor - qoftë të autorizuar apo sipas detyrës zyrtare - sepse sipas përvojës së tyre, avokatët kanë tendencë të shkaktojnë më shumë probleme sesa zgjidhje të çështjeve. Gjyqtari 2 shpjegoi se avokatët nganjëherë nuk i lejojnë të pandehurit të pranojnë fajësinë sepse duan të përfitojnë financiarisht nga i pandehuri. Gjyqtari 3 deklaroi se në shumicën e rasteve të pandehurit janë më të mirë se avokatët e tyre në mbrojtjen e tyre.

drejtat e tij/saj - veçanërisht gjatë negociatave për pranimin e fajësisë. Këta gjyqtarë të njëjtë gjithashtu theksuan se të pandehurit me avokatë mbërritën në gjykatë me një kuptim më të lartë të procedurave gjyqësore se sa të pandehurit e pa përfaqësuar.⁵⁸

Si alternativë ndaj ofrimit të ndihmës juridike falas, të gjithë gjyqtarët deklaruan se përpiqen të respektojnë të drejtat e të pandehurve kur ata nuk kanë përfaqësim ligjor. Në disa raste, gjyqtarët deklaruan se ata përpiqen të flasin 'të njëjtën gjuhë' si i pandehuri në mënyrë që ata të kuptojnë. Nga 13 gjykatësit e intervistuar, 10 prej tyre deklaruan se prokurorët gjithmonë përpiqen të gjejnë dëshmi shfajësuese në rastet kur ata emërohen siç kërkohet me ligj. Megjithatë, tre (3) gjyqtarë të intervistuar deklaruan se prokurorët rrallë paraqesin prova shfajësuese në dobi të pandehurve të pa përfaqësuar.

5.4 ANALIZA E VENDIMEVE GJYQËSORE TË FORMËS SË PRERË

IKD, gjatë analizës së dyzetepesë (45) vendimeve gjyqësore të zgjedhura rastësisht, që rezultojnë me dënim të shqiptuar nga Gjykatat Themelore në Prishtinë, Pejë dhe Prizren, kanë gjetur se veprat penale më të zakonshme, të bazuara në analizë, përfshinin: 11 lëndë të **Vjedhjeve së rënda**⁵⁹ të dënueshme me 3 deri në 7 vjet burgim, 6 lëndë të **Lëndimeve të lehta trupore**⁶⁰ të dënueshme me gjobë ose me burgim deri në tre vjet, 7 raste të **Vjedhjes**⁶¹ të dënueshme me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet, 7 raste të **Mashtrimit**⁶² të dënueshme me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muajsh, 4 raste të **Falsifikimit të dokumenteve**⁶³ të dënueshme me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

Nga 45 aktgjykimet e formës së prerë të analizuara, IKD ka gjetur se gjykatat shqiptuan dënime efektive me burgim në të gjitha këto raste. Dënimet e shqiptuara renditen nga burgosja prej 15 ditë deri në 3 vjet ose më shumë.⁶⁴

Për më tepër, nga 45 rastet e analizuara, 16 kishin përfaqësim ligjor sipas detyrës zyrtare në seancën finale, 24 kishin autorizuar përfaqësimin ligjor dhe 11 nuk kishin ndonjë përfaqësim ligjor.⁶⁵

Gjatë analizës së dyzet e pesë (45) vendimeve gjyqësore të formës së prerë, IKD konstatoi se gjykatat janë jashtëzakonisht të buta në lidhje me llogaritjen e shpenzimeve gjyqësore - veçanërisht për pagesat e përfaqësimit ligjor - të të pandehurve të dënuar të

⁵⁸ *Po aty.*

⁵⁹ Neni 327 i KPK-sw.

⁶⁰ *Po aty*, Neni 188.

⁶¹ *Po aty*, Neni 325.

⁶² *Po aty*, Neni 335.

⁶³ *Po aty*, Neni 398.

⁶⁴ Shtojca 1 - dënimet e shqiptuara nga divizionet penale në Gjykatat Themelore të Prishtinës, Pejës dhe Prizrenit.

⁶⁵ *Po aty.*

cilët, (nëse nuk janë të varfër), kërkohet me ligj të rimburojnë Shtetin.⁶⁶ Pavarësisht nga numri i seancave të mbajtura për secilën çështje gjyqësore - e cila shpesh tejkalon 3 deri në 5 seanca - gjykatat kanë vendosur në mënyrë të njëtrajtshme praktikën e caktimit të shpenzimeve gjyqësore nga vetëm 25 deri në 100 euro. Në të gjitha 45 vendimet e mbledhura, gjyqtarët injoruan detyrimin e tyre për të llogaritur kostot aktuale të mbrojtjes penale dhe në vend të kësaj nxirrnin një vendim në mënyrë uniforme, duke kërkuar që të pandehurit të paguanin një shumë paushall prej vetëm 25 deri në 100 euro mesatarisht. Kur kjo temë u ngritë gjatë Grupit të Fokusit të Akterëve të Sektorit të Drejtësisë në maj 2017, të gjithë pjesëmarrësit ranë dakord që humbja e financimit për shtetin që rezulton nga kjo praktikë nuk duhet të vazhdojë më.⁶⁷

⁶⁶ Neni 450(2) i KPPRK-së thotë në pjesën përkatëse: “Shpenzimet e procedurës penale përfshijnë si në vijim ... 2.7 shpërblimet dhe shpenzimet e nevojshme të mbrojtësit [përfshirë] . . . Neni 450(7) ... Shpërblimi dhe shpenzimet e nevojshme të mbrojtësit të caktuar nga Neni 57, paragrafi 2. apo 3. ose neni 58 i këtij Kodi paguhen nga mjetet buxhetore e jo nga i pandehuri [dhe në pajtim me Nenin 453(1) . . . i pandehuri fajtor. . . duhet të rimburojë shpenzimet e procedurës penale.”

⁶⁷ Grupi i Fokusit i Akterëve të Sektorit të Drejtësisë (maj 2017), Lidhur me praktikën aktuale të llogaritjes së shpenzimeve “paushall”, anëtarët e grupit të fokusit propozuan që gjyqtarët të përcaktojnë shpenzimet gjyqësore duke llogaritur me saktësi të gjitha shpenzimet e procedimit duke përfshirë të gjitha seancat gjyqësore, **shpenzimet e mbrojtjes juridike**, shpenzimet e dëshmitarëve ekspertë dhe pavarësisht nga totali i këtij shpenzimi, të lëshojnë urdhër për pagesën e të gjitha shpenzimeve për të pandehurit e dënuar, me përjashtim të rasteve kur ndihma juridike është pranuar në pajtim me gjendjen e dobët ekonomike të të pandehurit.

6. PËRFUNDIME

Pavarësisht nga hierarkia e themeluar në Kosovë e dispozitave kushtetuese të bazuara në KEDNJ dhe legjislacioni plotësues (KPPRK dhe ligji NJF) dhe ekzistenca e mekanizmave të shpërndarjes për ndihmë juridike falas, duke përfshirë Agjencinë e NJF, sistemi i ndihmës juridike falas i Kosovës nuk funksionon për të pandehurit e akuzuar për krime nën tetë (8) vjet burgim, të cilët nuk kanë mjete financiare për të pasur ndihmë juridike.


Ndihma juridike falas e sponsorizuar nga shteti është një e drejtë themelore e personit të akuzuar për një vepër penale që mund të përfshijë rrezik të jetës së tij ose të lirisë personale. Megjithatë, kjo e drejtë nuk është e pakufishme dhe i nënshtrohet kufizimeve të bazuara në kriteret e përcaktuara tashmë nga KEDNJ dhe shtrihet në një sërë vendimesh të GJEDNJ-së të cilat përfshijnë: 1) mjetet financiare, dhe 2) “interesin e drejtësisë” që është përcaktuar me tutje si një vlerësim i: a) seriozitetit të veprës dhe ashpërsisë së dënimit të mundshëm, b) kompleksitetit të çështjes; dhe c) gjendjes sociale dhe personale të të pandehurit.

Pa marrë parasysh nëse gjykatat zbatojnë në fund të fundit kriteret më gjithëpërfshirëse dhe liberale të përcaktuara në nenin 4 të Ligjit për NJF, ose kërkesat më pak strikte, por megjithatë është substanciale siç është përcaktuar edhe nga KEDNJ se, shteti ka një detyrim të pashmangshëm dhe të menjëhershëm për të llogaritur, për të ndarë, dhe për të ofruar fonde qeveritare në Agjencinë e NJF në mënyrë që gjykatat të mund t'u japin ndihmë ligjore si duhet të pandehurve të varfër në një mënyrë të pajtueshme me kornizën ligjore të Kosovës. Dështimi i shtetit për të siguruar burime të tilla për të pandehurit e varfër të akuzuar për një krim nën tetë (8) vjet burgim jo vetëm që shkel nenin 58 të KPPRK dhe nenin 4 të Ligjit për NJF, por gjithashtu bie në kundërshtim me nenin 30 (5) të Kushtetutës dhe nenin 6 (3) (c) të KEDNJ-së që zbatohen drejtpërdrejt në Kosovë. Në lidhje me identifikimin e fondeve ekzistuese, IKD gjithashtu arrin në përfundim se një shumë e konsiderueshme e tarifave ligjore “sipas detyrës zyrtare” të parimbursuara (nga të pandehurit e dënuar) paraqesin jo vetëm dështimin e gjykatave, por një burim potencial për lehtësimin e barrës financiare të Shtetit.

Ndërsa shqetësimi më i madh është mungesa e angazhimit të Shtetit për mbrojtjen e kësaj të drejte themelore nëpërmjet financimit të nevojshëm. Të dhënat e mbledhura nga IKD gjithashtu tregojnë se gjykatat, gjyqtarët, prokurorët dhe policia nuk e kuptojnë plotësisht mandatin e tyre kushtetues për të siguruar një avokat për të pandehurin e varfër kur këtë e kërkon interesi i drejtësisë.

7. REKOMANDIME

- Shteti duhet të ndajë buxhet të mjaftueshëm për të mbuluar shërbimet e ndihmës juridike falas për të pandehurit e varfër.
- Gjykatat duhet të fillojnë menjëherë të rikthejnë shpenzimet gjyqësore nga të pandehurit e dënuar, të cilët kanë marrë ndihmë juridike të financuar nga shteti pa pasur nevojë financiare për këto shërbime.
- Institucionet dhe organet në Sistemin Juridik të Kosovës duke përfshirë Odën e Avokatëve të Kosovës (OAK), Agjencinë e Ndihmës Juridike Falas, bashkësinë më të gjerë të avokatëve dhe qeverinë, duhet të bëjnë përpjekje për të ofruar shërbime juridike falas për ata qytetarë që nuk mund ta përballojnë atë.
- Gjyqtarët, prokurorët dhe policia duhet të zbatojnë nenin 4 të Ligjit për NJF dhe/ose të interpretojnë nenin 58 të KPPRP të Kosovës në përputhje me jurisprudencën e GjEDNj-së kur marrin vendime lidhur me “interesin e drejtësisë” që ndikojnë në të drejtat e të pandehurit sipas KEDNJ 6.3(c).
- Kuvendi duhet të ndryshojë nenin 58 të KPPRP-së në mënyrë që të qartësohet parimi i “interesit të drejtësisë” në mënyrë që të përcaktojë në mënyrë eksplicite kriteret e përcaktuara nga GjEDNJ: a) serioziteti i veprës dhe ashpërsia e dënimit të mundshëm, b) kompleksiteti i çështjes; dhe c) gjendja sociale dhe personale e të pandehurit.
- OAK, për shkak të detyrimit të saj kushtetues për të ofruar NJF, duhet të demonstrojë leadership duke avokuar për fondet e Shtetit për NJF-në, por gjithashtu të zgjerojë obligimet e tyre ekzistuese të OAK për punë *pro bono* (pa pagesë) nëpërmjet krijimit të mekanizmave (p.sh. Klinikat Juridike ose Qendra Probono) që u mundësojnë anëtarëve të OAK-së t’u ofrojnë qytetarëve të varfër përfaqësim falas në lëndët penale.
- Gjykata Supreme e Kosovës duhet të japë një opinion ligjor mbi zbatimin e praktikave të Gjykatës Evropiane lidhur me ofrimin e përfaqësimit ligjor të të pandehurve në të gjitha rastet penale.
- Gjykata e Apelit, me qëllim të unifikimit të praktikave në lidhje me politikën ndëshkuese, duhet të hartojë një udhëzim administrativ për përcaktimin e shumës së tërësishme (paushall) gjyqësore.
- Departamentet e Përgjithshme të zbatojnë nenin 450 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me çështjet penale.



Instituti i Kosovës për Drejtësi

Institut Prave Kosova

Kosovo Law Institute

www.kli-ks.org